



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 165/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Kamenicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Kamenicë, për shkak të mbulimit të posterave, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Kamenicë, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Kamenicë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5100 (pesëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 05.10.2013, nga LVV-ja, me të cilën pretendohet se me 04 tetor 2013 në rrugën “Skënderbeu” në Kamenicë anëtarë të subjektit politik AAK kanë mbuluar dhe kanë vendosur njoftimin e tyre mbi atë të LVV-së. Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë rast është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013, dhe neni 33 pika a) e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografën si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 05.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.10.2013, sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, në të cilën theksohet se vendosja e posterit të kandidatit të AAK-së është në pajtim me rregullat dhe ligjet dhe se LVV-ja ka bërë shkelje që është munduar të manipuloj si shkelje nga ana e jonë, ku edhe tregojnë qartë edhe fotot e dërguara nga ata ku të njëjtit kanë bërë shkelje duke e vendosur lajmërimin për tubim publik mbi posterin e kandidatit të AAK-së. Në përgjigje të ankesës subjekti politik kërkon që ankesa në fjalë të hidhet si e pabazuar dhe si dëshmi ka bashkangjitur udhëzimin e strukturave të AAK-së dhe shefave të shtabeve zgjedhore për respektimin e ligjit mbi zgjedhjet dhe rregullat zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si njoftimi i subjektit politik AAK është i vendosur mbi posterin (njoftimin) e LVV-së, gjë që e bënë përgjegjëse subjektin politik AAK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 4.1 pika a) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika a) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon heqjen, mbulimin, dëmtimin ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për fushatë zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga subjekti politik AAK, përveç thënieve se nuk kanë njohuri se kush e ka vendos posterin në fjalë, dhe se kryetari i këtij subjekti politik i ka kërkuar nga strukturat menaxhuse të AAK-së dhe shtabet zgjedhore të AAK-së, që të i respektojnë rregullat zgjedhore, subjekti politik në fjalë nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka ndërmarr veprime serioze siç kërkohet me nenin 32.6 të LZP-së, për evitimin e shkeljes së supozuar.

Pretendimet në përgjigje të ankesës nga subjekti politik AAK, se LVV-ja ka bërë shkelje në rastin e njëjtë duke e mbuluar posterin e kandidatit të AAK-së me njoftimin e parashtruesit të ankesës, nuk qendërojnë sepse në fotografimin me numër 1 (një) që gjendet në shkresat e lëndës vërehet qartë se njoftimi i LVV-së, është i vendosur nën posterin e kandidatit për kryetar të komunës së Kamenicës, i cili poster nuk është i mbuluar fare me posterin e LVV-së siç pretendohet në përgjigje të ankesës.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i konstaton se subjekti politik AAK në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj në kuptim të nenit 3.1 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) dhe 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrasa**

Anr. 165/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5,000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*